

VENDIM
Nr. 129, datë 31.5.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB - ENERGY” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 830/4 prot., datë 27.5.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Alb - Energy’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 65, datë 11.5.2017”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 101, datë 9.5.2022, vendosi të mosfillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 367, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhënë shoqërisë “Alb - Energy” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 65, datë 11.5.2017.

- Kjo vendimmarrje erdhi për arsye se ky aplikim nuk është paraqitur në afat, bazuar në përcaktimet e nenit 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, shoqëria u njoftua me shkresën nr. 693/4 prot., datë 18.5.2022, iu bë me dije se në mbështetje të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ajo mund të paraqesë në ERE një aplikim të ri, tashmë për licencim, brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të Bordit për mosfillim dhe dokumentacioni i paraqitur për qëllime të rinovimit të licencës do të konsiderohet i vlefshëm edhe për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Shoqërisë iu evidentua nevoja për të kryer edhe pagesën e diferencës që përkon me licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, prej 10,000 lekësh.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Alb - Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 696/5 prot., datë 19.5.2022, ka përcjellë në ERE: formatin e aplikimit të plotësuar tashmë për licencim dhe vërtetimin e kryerjes së diferencës së pagesës prej 10,000 lekësh.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe dokumentacionin teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1, gerrat “a”, “b”, “c”;
- dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gerrat “a”, “b”, “c”, “e”;
- dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gerrat: “a”, “b”, “c”, “d”;
- dokumentacionin teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, gerrat “b” dhe “c”. Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet e prokurorisë dhe gjykatës për vetë shoqërinë dhe për administratorin e saj;

- germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse). Shoqëria duhet të depozitojë strukturën e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të saj;

Dokumentacionin teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8:

- germa “a” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në gWh/sipas viteve). Shoqëria duhet të përcjellë sasi të që parashikon të tregtojë për vitet e ardhshme.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Alb - Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti